




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. \_\_\_\_\_  
 Nr. Iftau \_\_\_\_\_  
 Broj. stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages \_\_\_\_\_

Nr Prot \_\_\_\_\_  
 Br. Prot \_\_\_\_\_  
 Prot No \_\_\_\_\_  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum \_\_\_\_\_

DPK  
 02  
 03-02/4321/17  
 29.12.2017



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2017, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2472/17, për z. Flamur Zeqiri, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve Sh.A - Prishtinë, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë z. Flamur Zeqiri, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve Sh.A - Prishtinë dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat 'Ferma e Re' Sh.P.K, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi zyrtari i lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprime për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/3627/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni person i autorizuar në biznesin privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

